

TAKSAE PULLES
U PAGUA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERIA TIRANE

Nr. 455/3 Rep.
N. 455/3 Kol.



Tirane me 10/05/2018

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date **10/05/2018**, (dy mije e tetetëmbëdhjete), ditën e enjte, ora 10.00, përpara meje Noterit **Dhurata M Vardhami**, me zyre te ndodhur ne rrugën **Sami Frasheri**, u paraqiten palët kontraktuese si me poshtë :

PALA SHITESE: **Znj. Vasilika Mano** e lindur ne Sarande me 08/02/1973 mbajtese e kartes se identitetit **H35208049F** perfaqesuese e Shoqëria "ADR Trans" shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. me seli ne Blv Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla nr 2, Kati 5, Zyra 2A, Tirane e regjistruar si person juridik ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit me date 04/01/2013 me NIPT L31304034G, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori dhe ortakut i vetem **Znj. Vasilika Mano**, ne cilësinë e ortakut qe zotëron 10 % te kapitalit te shoqërisë "ADR Trans" sh.p.k., ne vijim i quajtur Shitës;

PALA BLERESE:

Shoqeria "NCI" shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Farke, Mjull Bathore, Rruga Akacia, Tirane e regjistruar si person juridik ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit me date 09/05/2014 me NIPT L41709011G e perfaqesuae ligjerisht nga Ortaku i vetem **Z. Besnik Halili** i cili zoteron 90% te kapitalit te shoqerise "ADR Trans", (ne vijim blerësi);

Parashtruar qe:

- Shoqëria "ADR Trans" Sh.p.k. me seli ne Blv Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla nr 2, Kati 5, Zyra 2A, Tirane e regjistruar si person juridik ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit me date 04/01/2013 me NIPT L31304034G, ka ortak te vetem Znj. Vasilika Mano, qe zotëron 100 % te kapitalit te shoqërisë "ADR Trans" sh.p.k., sipas ekstraktit te QKR-se dates 13/12/2017 i bashkëlidhur;

- Me vendim te Asamblesë se Ortakeve te Shoqerise "ADR Trans" sh.p.k. nr. 01 me date 09/05/2018, është vendosur shitja e kuotave ne masen 10% te kapitalit te shoqerise tek blerësi **Shoqeria "NCI"**.

- Shoqëria ka nevojë për investime dhe financime nëpërmjet pjesëmarrjes se ortakeve te rinj ne përbërjen e saj;

Sa me sipër u parashtrua është pjese integruese e kësaj kontrate.

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

Neni 1 Objekti kontratës

Ortaku i "ADR Trans" sh.p.k., **Znj. Vasilika Mano** vendos ti shesë 10% te kuotave qe zotëron ne Shoqërine "ADR Tran" sh.p.k. Bleresit si ne vijim:

Shoqeria "NCI" sh.p.k., me nga Ortaku i vetem **Z. Besnik Halili**, i shitet 10% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 10% te kapitalit dhe me numer kuote 1, i cili pranon ti blejë;

Neni 2 Çmimi dhe pagesa

2.1. Palët deklarojnë qe çmimi është paguar jashtë kësaj zyre noterie dhe nuk kane me asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

Neni 3 Pronësia dhe transferimi i kuotave

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palës blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet pales blerëse ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje. Nga ky moment blerësit i transferohet pronësia e kuotave dhe si pasoje shoqëria "ADR Trans" sh.p.k. do te ketë si ortake personat si vijojnë:

- **Shoqëria "NCI" sh.p.k.** do te zoteroje 100% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote.

Kjo kontrate u hartua ne baze te vendimit te Ortakevë **nr. 01 date 09/05/2018**, akteve te themelimit te shoqërisë dhe ne baze te ligjit n. 9901 date 14.04.2008 për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe konform kontrates se koncesionit se dates 11.09.2009.



PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITESE

Znj. Vasilika Mano

Vasilika Mano
Mano

PALA BLERESE

Shoqëria "NCI" shpk

Ortaku i vetem

Z. Besnik Halili

Besnik Halili

NOTERI
Dhurata M Vardhami



Dhurata M Vardhami

[Signature]